



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 24.29.1-2017-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË AUTORITETIT TË
AVIACIONIT CIVIL PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR
2017**

Prishtinë, prill 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Autoritetit të Aviacionit Civil në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Refiqe Morina (Udhëheqëse e ekipit) dhe Mjellma Dibra, Shemsije Llugiqi (anëtarë të ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Ramadan Gashi.

TABELA E PËRMBAJTJES


Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	14
5 Qeverisja e mirë.....	15
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	17
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme	20
Shtojca III: Letërkonfirmimi	22

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit të datës 07/02/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Autoritetit të Aviacionit Civil.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Autoritetit të Aviacionit Civil për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm


Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e Menaxhmentit në auditimin 2017

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil kanë marrë në konsideratë dhe janë pajtuar me të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit, si dhe janë zotuar se do t'i adresojnë rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Autoritetit të Aviacionit Civil. Ne kemi analizuar veprimtarinë e se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e Menaxhmentit ndaj gjetjeve tona mund të gjenden në Shtojcën III.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Autoritetit të Aviacionit Civil (AAC) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, nr.01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryesuesi i Bordit mbikëqyrës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të AAC-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

AAC-së i kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Planin e Prokurimit për vitin 2017; dhe
- PFV janë përgatitur me kohe dhe nënshkruar nga ZKA dhe ZKF.

Në kontekst të kërkesave për raportim, ne nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi.

Në PFV kemi identifikuar dobësitë si në vijim:

- Neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit, kolona e buxhetit final është prezantuar në vlerë 873,763€ në PVF, ndërsa sipas SIMFK-së buxheti final është 892,327€. Kemi një nënvlerësim prej 18,564€; dhe
- Neni 24 - Raporti për fondet e donatorëve të pashpenzuara nuk ishte shpalosur, ndërsa sipas SIMFK-së vlera e pashpenzuar e donacioneve është 4,694€.

DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI I AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, është e saktë për shkak se gjatë auditimit nuk janë identifikuar gabime materiale.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi 1 Kryesuesi i Bordit Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet lidhur me prezantimin jo të duhur të buxhetit final dhe donacioneve të pashpenzuar në PFV. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet në Ministri të Financave, përveç nëse ndaj PFV janë aplikuar të gjitha kontrollet dhe rishikimet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhimi financiar dhe kontrolli efektiv kërkojnë procese të rishikimit dhe udhëzues përcjellës të cilët sigurojnë zbatimin e plotë të ligjeve, rregulloreve të brendshme dhe proceseve të tjera të kontrollit. AAC ka kontrolle të duhura në raport me obligimet statutorë të saj. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrolleve mbi të hyrat si dhe shpenzimeve në përgjithësi, AAC kishte kontrolle adekuatë të cilat ishin duke u zbatuar në mënyrë efektive.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	925,274	892,327	839,595	832,147	824,469
Granti i Qeverisë -Buxheti	925,274	887,633	839,595	828,018	817,731
Donacionet e jashtme	-	4,694	-	4,129	6,738

Buxheti final në raport me atë fillestar të granti qeveritar ishte reduktuar për 37,641€, me vendime të Qeverisë Nr. 01/21 i datës 22 dhjetor 2017.

Donacioni i jashtëm në vlerë 4,694€ ishin pranuar në dhjetor të vitit 2017 nga „BEYOND H2020” i Unionit Evropian për projektin “Dizajnimi i procedurave të fluturimit përmes sinjalit satelitor” të cilin donacion AAC nuk ka arritur ta shpenzojë gjatë kësaj periudhe, prandaj kjo vlerë bartet për shpenzim në vitin 2018.

Në vitin 2017, AAC ka shpenzuar 839,595€ apo 94% të buxhetit final që është me ulët për 6% krahasuar me vitin 2016.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	925,274	892,327	839,595	832,147	824,469
Pagat dhe Mëditjet	688,484	658,484	639,919	625,223	622,980
Mallrat dhe Shërbimet	223,052	220,105	193,186	200,339	194,478
Shërbimet komunale	13,738	13,738	6,490	6,585	7,011

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Për kategorinë e pagave dhe mëditjeve kishte ndryshime në mes të buxhetit fillestar dhe atij final për 30,000€, kjo kishte ndodhur për arsyeje të kursimeve buxhetore. Teprica e mjeteve financiare në fund të vitit (18,565€) në raport me buxhetin final ishte si pasojë që dy (2) zyrtar kishin dhënë dorëheqje gjatë vitit 2017 dhe nuk ishin plotësuar ende këto pozita me staf të rregullt;
- Reduktimi i buxhetit për mallra dhe shërbime ishte 2,948€ me vendime të qeverisë për kursime. Teprica e mjeteve financiare në fund të vitit ishte (26,919€) në raport me buxhetin final, kjo kishte ndodhur si rrjedhojë e vonesave në zhvillimin e aktiviteteve dhe lidhja e kontratave nga ana e AQP-së në periudhën e fund vitit 2017. Realizimi i buxhetit final për këtë kategori ishte 88%; dhe
- Realizimi i buxhetit final në kategorinë e shërbimet komunale ishte 47%. Teprica e mjeteve financiare në fund të vitit ishte 7,248€ në raport me buxhetin final, kjo ka ndodhur si rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve të telefonisë fiks.

3.2 Të hyrat

Të hyrat e mbledhura nga AAC për vitin 2017 ishin në vlerë 1,865,064€. Në raport me vitin e kaluar shihet një rritje e të hyrave për 145,126€. Ky nivel i inkasimit të hyrave ka ndodhur për shkak rritjes së numrit të udhëtarëve gjatë viti 2017.

Burimi kryesor i të hyrave përbëhet nga tarifa e sigurisë së pasagjerëve me vlerë 1,847,534€ apo 99% e strukturës së të hyrave, tarifat për regjistrim të SAP² (mjete pa pilot) në vlerë 17,530€ si dhe nga gjobat tjera.

² SPA (rregullorja 01/2017 Për Sistemet e Mjeteve Ajrore pa Pilot).

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,600,000 ³	1,600,000	1,865,064	1,719,938	1,539,500
Totali	1,600,000	1,600,000	1,865,064	1,719,938	1,539,500

Të hyrat e mbledhur nga AAC deponohen në Buxhetin e Kosovës. Në mostrat e testuara nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave (payrollit) që menaxhohet nga MAP dhe MF. Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave janë listat e pagave të nënshkruara nga udhëheqësit e njësive organizative. Shpenzimet për paga gjatë vitit 2017 ishin 639,919€, të cilat janë realizuar në masën prej 97%.

AAC sipas buxhetit të aprovuar për vitin 2017, kishte (30) tridhjetë pozita, ku prej tyre 29 (njëzetëntë) të punësuarave ishin me orar të plotë dhe një me orar të shkurtuar.

Ne testuam pajtueshmërinë e listave të pagave me sistemin e pagave dhe pagesat sipas kontratës (punëtorët aktual, rekrutimet, largimet, pushimet e lehonave). Në mostrat e testuara nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.4 Menaxhimi i personelit

Në testuam pajtueshmërinë e dosjeve të personelit, procedurat e rekrutimit, pushimet e lehonisë, ndalesat dhe masat e ndërmarrura nga AAC-ja. Nga testimet e bëra është verifikuar se gjitha ndryshimet e ndodhura janë bërë në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

³ AAC nuk kishte plan detal të të hyrave, por vlera e prezantuar të buxheti fillestar dhe ai final është marrë nga formulari i kërkesës buxhetore(PCF4).

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime, duke përfshirë dhe shërbimet komunale në vitin 2017 ishte 233,843€, ndërsa prej tyre ishin shpenzuar 199,676€ apo 85% e buxhetit final. Pjesa më e madhe e shpenzimeve në këto kategori përfshijnë shpenzime operative (udhëtimet zyrtare, qiraja e objektit, shpenzimet e telefonisë mobile), si dhe shpenzimet komunale. Në mostrat e testuara nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar.

AAC-ja në Planin e Prokurimit për vitin 2017 kishte planifikuar (8) tetë proceduara të prokurimit që ishin realizuar nga AQP-ja. Kjo si rrjedhojë që LPP nr. 04/L-042 (me ndryshime dhe plotësime), nenit 21a përcakton se për qëllime të ekonomizimit të aktiviteteve të prokurimit për Agjencitë e Pavarura të cilat i përgjigjen Kuvendit të Republikës së Kosovës që kanë më pak se 50 (pesëdhjetë) punonjës, procedurat e prokurimit i kryen AQP-ja.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.6 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Një sistem i mirëfilltë i menaxhimit të pasurive kërkon përcaktim të qartë të rrjedhjes së detyrave për regjistrimin, krahasimin, raportimin dhe shpalosjen e tyre në PVF.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores së MF nr.02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore.

ACC-ja në PFV kishte prezantuar pasurinë mbi 1,000€ në vlerë zero, ndërsa pasuria jo-kapitale nën 1,000€ në vlerë 1,745€ si dhe stoqet në vlerë 6,007€. Në mostrat e testuara nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.7 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme sipas të dhënave në PFV ishte 261,384€ për vitin 2017. Struktura e llogarive të arkëtueshme përbëhet nga tarifa e sigurisë së pasagjerëve (257,434€) të cilat mblidhen sipas marrëveshjes në mes të Koncesionit 'LIMAK Kosovo Adem Jashari' dhe AAC të cilat transferohen 45 ditë pas përfundimit të muajit në buxhet të Kosovës, lëshimi i çertifikatës për organizata trajnuese (2,000€), tarifa për ripërtëritjen e licencës (1,150€) dhe gjobat (800€).

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.8 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 7,175€. Në përgjithësi ACC-ja ka kontrollë të mira në menaxhimin e obligimeve. Vlera e mbetur si obligim është për shkak se pjesa më e madhe e faturave (furnizim dhe shërbime) kanë ndodhur në muajin dhjetor 2017, ndërsa faturat janë pranuar gjatë janarit të 2018, kështu që ACC-ja nuk kishte pasur mundësi t'i paguaj ato dhe si rezultat janë bartur për t'u paguar në vitin 2018.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016 të AAC-së ka rezultuar në (4) katër rekomandime. AAC kishte përgatitur një Plan Veprimi brenda 30 ditëve pas pranimin të raportit të auditimit për PFV për vitin 2016 të ZKA, ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, rekomandimet e dhëna nga ZKA për vitet 2016 dhe 2015 janë zbatuar në tërësi nga ACC-ja. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë përfshinë parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisja e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit, kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Qeverisja në AAC në lidhje me llogaridhënien dhe cilësinë e raportimit menaxherial reflekton një ambient pozitiv.

ACC-ja kishte hartuar planin strategjik dhe regjistrin e rreziqeve me të cilën mund të ballafaqohet dhe masat që mund të ndërmerren në arritjen e objektivave të saj.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit, për të cilën ACC-ja kishte arrit t'i zbatoj gjitha rekomandimet e viteve të kaluara. Po ashtu pyetësonin e vetëvlerësimit, ACC-ja ka marrë në konsideratë kërkesat ligjore të parapara me rregullat e MFK-së dhe ka përfunduar me kohë dhe cilësi vetëvlerësimin që është kryer nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Auditimi i brendshëm është segment i rëndësishëm për të siguruar menaxhmentin e lartë se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe zbatohen në mënyrën e duhur. Aty ku vërehet se kontrollet e brendshme nuk funksionojnë si duhet, auditimi i brendshëm ofron këshilla dhe rekomandime se si ato të përmirësohen.

Në bazë të UA Nr.23/2009 për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, ACC-ja nuk i plotëson kriteret⁴ për themelimin e NjAB-së.

Në mungesë të NjAB-së, auditimi i brendshëm kryhet nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm (DAB) në kuadër të Ministrisë së Financave (MF), si rezultat gjatë vitit 2017 nuk ishte zhvilluar ndonjë proces i auditimit të brendshëm nga DAB për ACC-në. Ne inkurajojmë menaxhmentin që të bëjë një rishikim të nevojave për auditim të brendshëm dhe të konsiderojë mundësinë e arritjes së një marrëveshje me ndonjë organizatë tjetër të sektorit publik që të shfrytëzojë shërbimet e auditimit të brendshëm.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara. Procesi i raportimit të brendshëm në AAC funksionon sipas zingjirit llogaridhënës dhe strukturës organizative. Lidhur me këtë, menaxhmenti kishte zhvilluar takime të rregullta për vitin 2017, duke diskutuar dhe raportuar në baza javore, mujore dhe tremujore mbi të hyrat dhe shpenzimet dhe për të gjitha aktivitetet tjera të zhvilluara në AAC.

⁴ (mbi 1 milion buxhet, 50 staf të punësuar, si dhe shkallë të lartë të rrezikshmërisë)

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
2.5 Menaxhimi i rrezikut	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është ndërmarrë një analizë e hollësishme e rreziqeve të identifikuara duke bërë vlerësimin e tyre dhe të reagoar ndaj këtyre rreziqeve për të ngritur efektivitetin e menaxhimit të rrezikut.	Rekomandimi është zbatuar, janë marrë masat e duhura.		
4.6 Pasuritë dhe detyrimet	Drejtori i Përgjithshëm të sigurohet që janë marr masa shtesë duke ju përkujtuar poseduesve të pasurisë, procedurat dhe kërkesat ligjore për shfrytëzimin dhe kthimin e pasurisë.	Rekomandimi është zbatuar, janë marrë masat e duhura.		
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
3.1.1 Të hyrat	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë që është ndërmarrë një shqyrtim i kontrolleve në lidhje me lëshimin e certifikatave. Proceset e rishikuara duhet të sigurojnë që certifikatat të lëshohen vetëm pasi të kryhen obligimet, sipas kërkesave të rregullores.	Rekomandimi është zbatuar, janë marrë masat e duhura.		

3.2 Pasuritë	Drejtori i Përgjithshëm duhet t'i rishikojnë kontrollet ekzistuese për të siguruar menaxhim efikas dhe regjistrimin e gjithë pasurisë që të ruhen nga humbja apo keqpërdorimi. Ne këtë aspekt të ndërmerren veprime për funksionalizmin e regjistrimit e-pasuria.	Rekomandimi është zbatuar, janë marrë masat e duhura.		
3.2.2 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj	Drejtori i Përgjithshëm duhet të rishikojnë kontrollet ekzistuese në lidhje me mbylljen e avanseve për paranë e imët për të siguruar mbylljen e tyre sipas afateve të përcaktuara.	Rekomandimi është zbatuar, janë marrë masat e duhura.		
3.3 Obligimet e papaguara	Drejtori i Përgjithshëm duhet që të ndërmarrin veprime të nevojshme për të siguruar raportim të drejtë të obligimeve të papaguara dhe të përcillen/monitorohen deri sa të paguhen.	Rekomandimi është zbatuar.		

Shtojca III: Letërkonfirmimi

 Republika e Kosovës Republika Kosovo - Republic of Kosovo	 CAA Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës / Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova / Civil Aviation Authority of Kosovo	 CAA Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës / Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova / Civil Aviation Authority of Kosovo
--	--	--

Nr. i prot.	2018 / 205 / 18	
Brigjet/Prot. Nr.	Kopje	Data
1	ADM	27.04.2018
Stranica/Pages	Kopja/Copy	Datum/Date
Hyrje/Inazmim	<input type="checkbox"/>	
Dalje/elektronik	<input checked="" type="checkbox"/>	
Brendshëm/Internacional	<input type="checkbox"/>	
	Prishtinë/Prishtina/Pristina	

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2017 dhe për implementimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit
Prishtinë, dt. 27.04.2018

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Raportit Financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.


 Drejtori i Përgjithshëm:

	Tel: +381 (0)38 248 629 Fax: +381 (0)38 211 009 info@caa-ks.org www.caa-ks.org Fruga Ahmet Krasniqi p.n, Lagja Arbëria 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
---	--